



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 118, Datë 10.06.2024

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “SMART TRADE & CONSULTING” SH.P.K. PËR
HEQJEN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, gërma “dh” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, gërma “dh”, 7, paragrafi 2 dhe 9, gërma “d”, të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe pikës 5.1, gërma “dh”, të Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.06.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 965/4 prot., datë 07.06.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “SMART Trade & Consulting” sh.p.k për heqjen e licencës”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “SMART Trade & Consulting” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 389 seria T17/T22, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 173, datë 26.10.2017, rinovuar me vendimin nr. 235, datë 22.09.2022, për një afat 5-vjeçar (deri më 27.10.2027).
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 965/2 prot., datë 03.05.2024, është paraqitur në ERE shkresa e nënshkruar nga administratori i shoqërisë “SMART Trade & Consulting” sh.p.k, vulosur me vulën e shoqërisë së licencuar, ku kërkohet heqja e kësaj licence.
- Shoqëria “SMART Trade & Consulting” sh.p.k ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.
- Në nenin 42, pika 1, gërma “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenin 5, gërma “dh”, të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, miratuar me vendimin nr. 58, datë 18.04.2017, pikën 5.1, gërma “dh” të Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të Energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.06.2016, përcaktohet se ERE heq një licencë me kërkesë të të licencuarit.
- Në nenin 7, paragrafi 2 i Rregullores së sipërcituar përcaktohet se: Në rast se i licencuari është propozuar për t’iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat “dh”

dhe/ose "e" të nenit 5 të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9 të kësaj rregulloreje, ndërsa në nenin 9, gërma "d" të kësaj rregulloreje parashikohet se ...Bordi do të vendosë për të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat "dh" dhe / ose "e" të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 7 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje.

- Duke qenë se ndodhemi në kushtet kur kërkesa për heqjen e licencës vjen nga vetë i licencuari, vlerësohet të procedohet menjëherë me miratimin e kësaj kërkesë dhe heqjen e licencës. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, kjo licencë e humbet fuqinë juridike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë "SMART Trade & Consulting" sh.p.k., për heqjen e licencës nr. 389 seria T17/T22, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 173, datë 26.10.2017, rinovuar me vendimin nr. 235, datë 22.09.2022.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar e humbet fuqinë juridike.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "SMART Trade & Consulting" sh.p.k., shoqërinë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" sh.a, dhe shoqërinë "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX" sh.a, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI

Petrit AHMETI